



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29890, dt. 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënieën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e bashkëpronarëve privat Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 20/2025

Mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Ndërtimit të Objektivit të Ri të Administratës Komunale dhe Formimit të Rrugës tek Ura e Re". si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të ndërtimit të objektivit të ri të Administratës Komunale dhe formimit të rrugës tek ura e re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë pronë e pronarit Arton (Sali) Kelmendi dhe ngastra nr.2729-0 në sipërfaqe 289m² ZK Pejë me shtëpi, pronë e bashkëpronarëve Arton (Sali) Kelmendi dhe Egzana (Sejfedin) Kelmendi, do të merren me qëllim të ndërtimit të objektivit të ri të Administratës Komunale dhe formimit të Rrugës tek Ura e Re si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me ½ e ngastrës kadastrale nr.5755-118 e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej 7641m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme të aprovuara me datën 29.05.2025.

- Prona e **Komunës së Pejës**, ngastra kadastrale nr.5755-118 në sipërfaqe prej 7641m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² apo totali 611,280.00 €, e që i bie se ½ e kësaj ngastre është vlerësuar me gjithsej 305,640.00 €.

- Prona private e pronarit **Arton (Sali) Kelmendi**, ngastra kadastrale nr.5502-3 në sipërfaqe prej 272m² ZK Pejë është vlerësuar me 110.00 €/m² që në total i bie 29,920.00 €.

- ngastra në pronësi të **Arton (Sali) Kelmendi** dhe **Egzana (Sejfedin) Kelmendi** me nr.2729-0 në sipërfaqe prej 289m² ZK Pejë me shtëpi është vlerësuar me 600.00 €/m², ndërsa vlera e investimeve është vlerësuar me 112,200.00 €, që në total i bie **285,600.00 €**.

Pra, të dyja këto ngastra në pronësi private të **Arton (Sali) Kelmendi** dhe **Egzana (Sejfedin) Kelmendi** së bashku me investimet janë vlerësuar në total **315,520.00 €**.

- Andaj obligohet Komuna e Pejës që të paguajë diferencën në shumën prej **9,880.00 €** **Arton (Sali) Kelmendit** dhe **Egzana (Sejfedin) Kelmendit** bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj



Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.